

Pyetje/Përgjigje - Plani i rishqyrtimit të Plotë të Shkollave



Drejtoria Arsimore e Filadelfias ka një vizion të qartë: Që të gjithë fëmijët të shkojnë në një shkollë të mirë, afër vendit ku jetojnë. Për të arritur këtë vizion, duke filluar nga vjeshta e vitit 2019, Drejtoria do të jetë partner me ekspertë të industrisë për të udhëhequr një përmbledhje shumëvjeçare të Planit të Rishqyrtimit të Plotë të Shkollave (CSPR) të krijuara për të pasur një vështrim strategjik dhe të gjerë në sistemin se si popullatat dhe komunitetet në të gjithë qytetin janë parashikuar të ndryshojnë në vitet e ardhshme.

1. CILI ËSHTË QËLLIMI I PUNËS DHE REZULTATET E PRITURA?

Qëllimi i përgjithshëm është që Drejtoria të krijojë shkolla në çdo lagje që plotësojnë nevojat arsimore të ndryshimit të popullsisë duke:

- zgjedhur vendimin më të përpunuar në lidhje me shfrytëzimin e ndërtesave tona për të siguruar që nxënësit të shkojnë në një shkollë me cilësi të lartë afër vendit ku ata jetojnë
- duke investuar kapital aty ku nevojitet më shumë
- krijimi i tranzicioneve të matura për nxënësit në klasat fillore dhe të mesme

2. A PËRFSHIHET SHKOLLA IME?

Të gjitha shkollat janë të përfshira në këtë iniciativë. Shkollat janë grupuar në një nga katër ciklet. Rishikimi i cikleve është planifikuar të fillojë në vjeshtën e çdo viti. Charter schools nuk janë pjesë e procesit të rishikimit.

3. KUR DUHET TË FILLOJË?

Cikli i parë fillon në vjeshtën e vitit 2019.

4. SI MUND TA GJEJE QE NE CFARE CIKEL TE RISHIKIMIT ËSHTË SHKOLLA IME ?

Lista e shkollave sipas ciklit mund të gjendet në faqen e internetit të CSPR: www.philasd.org/cspr

5. SI KENI VENDOSUR TË GRUPONI SHKOLLAT NË ÇDO CIKËL?

Të gjitha lagjet tona janë të rëndësishme. Ne i grupuam ato mbi bazën e një sërë konsideratash, duke përfshirë:

- vendndodhjen dhe afërsinë e tyre me njëra-tjetren,
- ndërgjegjësimi ekzistues i luhatjeve në regjistrim, dhe
- planet ekzistuese për investime kapitale.

6. PSE CSPR MERR SHUMË VITE PËR T'U PLOTËSUAR?

Ky lloj planifikimi kërkon kohë dhe ne kemi shumë shkolla, nëpër shumë lagje me tregimet e tyre unike. Ne duhet ta bëjmë këtë duke u menduar mire. Pra, ne kemi vendosur shkolla në zona të vogla të studimit brenda katër cikleve për t'i dhënë çdo grupim vëmendjen individuale që kërkon.

Ndër të tjera, ne jemi veçanërisht të interesuar për angazhimin e komuniteteve të shkollave në dialog të rëndësishëm për vendimet që ndikojnë në shkollat e tyre. Ne duam të sigurojmë që zëri i prindërve dhe i komunitetit të dëgjohet dukshëm në rekomandimet përfundimtare që do t'i paraqiten Bordit të Arsimit për miratim. Pra, afati kohor pasqyron përfshirjen e një numri takimesh rreth angazhimit të komunitetit.

7. A ËSHTË KJO PËR NDRYSHIMET KUFITARE?

Aspak. Ka shumë faktorë që duhet të merren parasysh dhe shumë zgjidhje për të zgjedhur, varësisht nga nevojat. Për shembull, mund të gjejmë se zgjidhja më e mirë është të zgjerojmë ose të pakësojmë klasa të caktuara, të ndërtojmë hapësira shtesë, të investojmë në mënyra më efikase për të përdorur hapësirën ekzistuese, të sjellim programe së bashku për të ndarë burimet ose për të kaluar programet në vende më logjike. Ndryshimet në kufijtë janë ndonjëherë të nevojshme, por kjo është vetëm një nga shumë opsione.

8. KUSH PO NDIHMON ME KËTË RISHIKIM?

Ne jemi duke angazhuar ekspertë kombëtarë për të përfunduar projeksionet për numrin e nxënësve që Drejtorja pret të shërbejë gjatë 10 viteve të ardhshme. Ky informacion, së bashku me të dhënat për performancën e shkollës dhe cilësinë e ndërtimit, do të përdoren nga komitetet e planifikimit për t'i bërë rekomandime Administratorit të Përgjithshëm dhe Bordit të Arsimit

9. SI MUND TË MARR PJSË?

Dy mënyra. Çdo Zonë Studimi do të ketë një komitet planifikimi që përfshin dy përfaqësues të prindërve. Këto komitete do të punojnë së bashku me personelin e Drejtorisë dhe konsulentët e industrisë për t'u këshilluar dhe informuar rekomandimet që do t'i paraqiten Bordit të Shkollës dhe për të ndarë informacionin në komunitet. Nëse jeni të interesuar të shërbeni në komitetin e planifikimit të shkollës suaj, ju lutemi kontaktoni drejtorin tuaj të shkollës.

Por ju nuk duhet të jeni në Komision që t'ju dëgjohet zeri juaj por, të gjithë prindërit dhe anëtarët e komunitetit do të kenë mundësi të shumta për të ndjekur mbledhjet informative gjatë gjithë ciklit të rishikimit dhe gjithashtu mund të deshmojnë në mbledhjet mujore të Veprimt të Bordit të Arsimit.

10. KUR DO TË ZBATOHEN REKOMANDIMET NGA CIKLET?

Rekomandimet e miratuara nga Bordi në pranverë do të hyjnë në fuqi jo më shpejt se vjeshta e vitit të ardhshëm kalendarik. Për shembull, rekomandimet e miratuara në pranverë 2020, do të zbatohen për vitin shkollor 2021-2022.

11. SI MUND TË JEM I INFORMUAR PËR TE GJITHA KETO INFORMACIONE?

Ne kemi mbledhur të gjitha informacionet e deritanishme rreth CSPR, duke përfshirë procesin dhe afatet kohore, në faqen tonë të internetit www.philasd.org/CSPR. Do t'ju njoftojmë rregullisht me oraret e takimeve dhe raportet e progresit, pasi ato bëhen të disponueshme. Ekziston edhe një formë e-mail në faqe, për të paraqitur ndonjë pyetje shtesë, në çdo kohë. Një anëtar i ekipit tonë do të përgjigjet në kohën e duhur.